

# 30 DITË në AMA

**DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE**



Fq. 2

**Krasniqi në Bruksel në takimin e 17-të të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri: Progresi i bërë në drejtim të Lirisë së Shprehjes është i matshëm**


**Nënshkruhet marrëveshja teknike për koordinimin e frekuencave digjitale mes Shqipërisë dhe Kosovës**

Nënshkruhet në Tiranë, mes Shqipërisë dhe Kosovës, marrëveshja teknike për koordinimin e planit të frekuencave për...



Fq. 2

**DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X**




Fq. 2

**Mbrojtja e prodhimit audioviziv shqiptar, pas kërkesës së AMA-s hiqet nga Google Play Store aplikacioni “Kanali im” dhe “Shiko Shqip”**

Aplikacionet “Kanali im” dhe “Shiko Shqip”, të cilët transmetonin në...

**Kryetarja e AMA-s zhvillon konsultimin me përfaqësues të OSHMA-ve për ndryshimin e rregullores së komunikimeve tregtare audiovizive**

Kryetarja e AMA-s priti përfaqësues të OSHMA-ve me të cilët konsultoi disa...



Fq. 2



Fq. 2

**Takimi i TAIEX, diskutohet për afrimi i legjislacionit të vendeve kandidate me Aktin European për Shërbimet Digjitale**

Me fokus për afrimin ligjor me Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit European (DSA), u zhvillua në Bruksel një takim shumëpalësh i TAIEX,...

## Krasniqi në Bruksel në takimin e 17-të të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri: Progresi i bërë në drejtim të Lirisë së Shprehjes është i matshëm


Kryetarja e AMA-s mori pjesë në takimin e 17-të të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri organizuar në Bruksel. Gjatë këtij takimi Znj. Armela Krasniqi, paraqiti progresin konkret në forcimin e pavarësisë institucionale, eficiencës rregullatore dhe qëndrueshmërisë gjyqësore të vendimmarrjes, si dhe hapat e ndërmarrë për përafrimin e plotë me kuadrin europian.

[Lexo më shumë](#)



## Nënshkruhet marrëveshja teknike për koordinimin e frekuencave digjitale mes Shqipërisë dhe Kosovës

Nënshkruhet në Tiranë, mes Shqipërisë dhe Kosovës, marrëveshja teknike për koordinimin e planit të frekuencave për transmetimet televizive digjitale tokësore (DDT), në brezin 470–694 MHz. Kjo marrëveshje e firmosur nga Znj. Armela Krasniqi, kryetare e AMA-s dhe Z. Fitim Veliu, anëtar i Komisionit të Pavarur të Medias së Kosovës, synon koordinimin e planeve digjitale të frekuencave të secilit shtet, duke garantuar shmangien e interferencave ndërkufitare dhe sigurimin e ofritit të shërbimeve audiovizive pa ndërprerje. [Lexo më shumë](#)



## Mbrojtja e prodhimit audioviziv shqiptar, pas kërkesës së AMA-s hiqet nga Google Play Store aplikacioni “Kanali im” dhe “Shiko Shqip”

Aplikacionet “Kanali im” dhe “Shiko Shqip”, të cilët transmetonin në mënyrë të paligjshme kanale televizive shqiptare, janë hequr nga Google Play Store pas konstatimit të shkëlqejve të drejtave të transmetimit. Kërkesa erdhi pas një procesi verifikimi nga ekipet e inspektimit të AMA-s, të cilat evidentuan se aplikacionet ofronin akses të paautorizuar në kanale televizive shqiptare dhe përmbajtje audiovizive të mbrojtura me të drejta.

[Lexo më shumë](#)

## Kryetarja e AMA-s zhvillon konsultimin me përfaqësues të OSHMA-ve për ndryshimin e rregullores së komunikimeve tregtare audiovizive



Kryetarja e AMA-s priti përfaqësues të OSHMA-ve me të cilët konsultoi disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren, “Për komunikimet audio dhe audiovizive me natyrë tregtare, format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimet e reklamave”. Konsultimi erdhi si pasojë e ndryshimeve ligjore që vijnë pas transpozimit të Direktivës Europiane për Transmetimet Audiovizive.

[Lexo më shumë](#)



## Takimi i TAIEX, diskutohet përafrimi i legjislacionit të vendeve kandidatë me Aktin European për Shërbimet Digjitale

Me fokus përafrimin ligjor me Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit European (DSA), u zhvillua në Bruksel një takim shumëpalësh i TAIEX, organizuar nga Komisioni European. Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi, prezantoi zhvillimet më të fundit në zbatimin e DSA-së në Bashkimin European. Diskutimet u përqendruan në çështje kyçe si mbrojtja e fëmijëve në internet, garantimi i integritetit të proceseve zgjedhore në hapësirën digjitale, siguria e tregjeve online dhe mekanizmat për trajtimin e rreziqeve sistematike që lidhen me platformat e mëdha digjitale. [Lexo më shumë](#)

## Lufta kundër piraterisë në vitin 2025: U bllokuan 14 servera të paligjshëm, 579 linqe pirate u hoqën nga platformat e shpërndarjes së videove

Lufta kundër piraterisë audiovizive ka qenë në qendër të vëmendjes së punës së Autoritetit të Mediave Audiovizive edhe gjatë vitit 2025. Falë punës së vazhdueshme në terren, ekipet e AMA-s arritën të mbyllnin 10 servera pirate në Shqipëri dhe 4 të tjerë u bllokuan jashtë vendit. Gjithashtu u referuan për t'u mbyllur 334 faqe online ndërsa 579 linqe pirate u hoqën nga platformat e shpërndarjes së videove.

[Lexo më shumë](#)



## Selanik, kryetarja e AMA-s merr pjesë në konferencën ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve

Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në Konferencën e 3-të Ndërkombëtare për Sigurinë e Gazetarëve, organizuar nga Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Sigurinë e Gazetarëve dhe Profesionistëve të Medias (ICSJ), zhvilluar në Selanik. Tema kryesore e këtij takimi ishte "Të dëshmosh: Trauma dhe qëndrueshmëria në gazetarinë moderne".

[Lexo më shumë](#)

